

N j o f t i m P u b l i k

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr.350/02-97162/25 dt.07.07.2025 (sipas eLeja-KKN-00477), në emër të kërkuësve: Pronarëve, Jusuf Pllana, Isak Sinani, Maliq Hagjija, Ali Binakaj, Xhafer Jashari, Sadri Raçi, Fehmi Raçi, Rexhep Dedinca nga Prishtina, me Investitor “F&P Construction” sh.p.k. nga Peja me certifikat të biznesit me numër unik identifikues 810748212 me pronar Patriot Hadërgjonaj nga Peja, përmes së cilës kërkohet caktimi i kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës banesore dhe afariste - Ndërtesa “F&P Residences” me etazhitet 2B+S+P+9+Nk, në kuadër të Planit Rregullues “Kalabria”, Blloku Urban “B10” dhe “B13” Tërësisë Hapësinore B të Planit Rregullues të Hollësishëm "Kalabria" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.10083-2, 07588-44, 07588-45, 07588-43, 07588-40, 07588-16, 07588-19, ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **22.07.2025** deri më **05.08.2025**, në e-mail adresën: **urbanizmprištine@rks-gov.net**.

Kushtet e propozuara të ndërtimit - Ndërtesa “F&P Residences” me etazhitet 2B+S+P+9+Nk	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	“Arë e klasit 2” / Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	7.50’ m nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ 37.50m’ / 7.5 m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	~25.00m’ / 7.5 m’ anësore majtas ~32.00m’ / 19.4 m’ - anësore djathtas ~19.00m’ / 9.5m’ e pasme / hyrja
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=34.7%-me Vendim te kryetarit
g. Përqindja e sipërfaqes se gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=30% parter + 10% kulmi
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN= B10-2.4 dhe B13-3.0 (e propozuar sipas planit rregullues)
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=80% (e propozuar sipas planit rregullues)
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	103 në bodrum, në objekt + 7 mbi tokë
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Fasadë ventiluese dhe demit fasadë
m. A ka qasje te pakufizuar ne rruge publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
n. shfrytëzimi i propozuar a do te gjenerojë ndotje te mjedisit apo zhurmë me te madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore ne Zona te Mbrojtura, Zona te veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: _____